



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr. 9018/2010

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DIVIZIONI PËR KUNDERVAJTJE- me Gjyqtarin Gani Kastrati ,me procesmbajtësjen Mire Beqiraj në procedurën kundervajtëse kundër të pandehurit: Xhelal Canziba , anëtarë I bordit kompania rajonale e mbeturinave „Eko Regjioni”, Prizren (mungon adresa) , përshkak të kundërvajtjes nga neni 16 paragrafi 1, të Ligjit për deklarimin, preardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, dhe në bazë të nenit 195, të Ligjit kundervajtjeve (“G.z. e Kosovës” nr.23/79),me 06.02.2013, merrë këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET -procedura kundervajtëse kundër të pandehurit: Xhelal Canziba- anëtarë I bordit kompania rajonale e mbeturinave „Eko Regjioni”, Prizren (mungon adresa) , përshkak të kundërvajtjes nga neni 16 paragrafi 1, të Ligjit për deklarimin, preardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë public.

Sepse është shkaktuar parashkrimi për zhvillimin e procedurës kundervajtëse në bazë të nenit 198 al. 1 pika 7, të LMK-së, e konform nenit 27, të të njejtit Ligjë, sepse ka arritur parashkrim absolut , pasi që nga dita e kryerjes së kundërvajtjes kanë kaluar më tepër se dy vite .

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të Gjykatës Themelore për Kundervajtje në Prizren.

A R S Y E T I M

Me kërkesën e Agjencisë Kundër korrupsionit , nr.01/2268/10, të dt. 08.06.2010, është inicuar procedura kundervajtjese kundër të pandehurit: Xhelal Canziba-anëtarë I bordit kompania rajonale e mbeturinave „Eko Regjioni”, Prizren (mungon adresa) , përshkak të kundërvajtjes në veshtrim të nenit 9 dhe 10 të Ligjit për njesit matëse (K. Kosovës, nr. 2042/11).

Pas zbatimit të procedurës kundërvajtëse edhe përkundër ndërmarrjes së veprimeve procedurale Gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për pezullimin e procedurës përshkak të parashkrimit absolut ,pasi gjyqtari paraprak I qështjes nuk ka ndermarrë veprime procedurale për zhvillimin e procedurës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 198 al. 1 pika 7, të LMK-së, pasi që kanë kaluar më shumë se dy vite, nga data e kryerjes së kundërvajtjes .

Me sa është cekur mbi e sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DIVIZIONI PËR KUNDERVAJTJE

Regj. 9018/2010

Me procesmbajtësen

Mire Beqiraj

Me dt. 06.02.2013

Gjyqtarin

Gani Kastrati

UDHEZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit-divizioni për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nëpërmes kësaj Gjykate.